



**KONTRATA SOCIALE
KORÇË**

**RAPORT MBI
MONITORIMIN E
PËRMBUSHJES SË
PRIORITETEVE
DHJETOR 2021-SHTATOR 2022**

**PUBLIKIMI I DYTË I MONITORIMIT
PËRGATITUR NGA:
GRUAJA NË ZHVILLIM KORÇË**

**RAPORTI MBI MONITORIMIN E PËRMBUSHJES SË PRIORITETEVE
TË KONTRATËS SOCIALE**

BASHKIA KORÇË

POP – PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

Dhjetor 2021 – Shtator 2022

Përgatiti raportin: Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë”

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe National Endowment for Democracy.

Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra "Për Zhvillimin e Shoqërisë Civile", Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë;
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Qendra "Epoka e Re", Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës;
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan;
- “Gruaja në Zhvillim Korçë”, Korçë.

Ky Raport është përgatitur nga Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” në kuadër të projektit POP 2022 “Kontrata Sociale si mjet efektiv për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje në nivel vendor dhe transparenca” dhe nuk përfaqëson qëndrimin e Olof Palme International Center dhe National Endowment for Democracy. Gjetjet dhe qëndrimet në raport janë përgjegjësi vetëm e autorëve.

Tabela Përmbledhëse

SHKURTIME	4
FALENDERIME.....	5
HYRJE	6
METODOLOGJIA.....	8
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	9
ANALIZA E GJETJEVE PËR SECILIN PRIORITET SIPAS KONTRATËS SOCIALE.....	12
GJETJET NGA MONITORIMI DHE INFORMACIONI I BASHKISË KORÇË	12
<i>PRIORITETI 1:.....</i>	<i>12</i>
<i>PRIORITETI 2 :</i>	<i>14</i>
<i>PRIORITETI 3:.....</i>	<i>15</i>
<i>PRIORITETI 4:.....</i>	<i>16</i>
<i>PRIORITETI 5:.....</i>	<i>18</i>
<i>PRIORITETI 6 :</i>	<i>19</i>
VLERËSIM I THELLUAR DHE PËRFUNDIME	20
ANEKSE.....	22
<i>ANEKS 1. PARAQITJA GRAFIKE E REZULTATEVE.....</i>	<i>22</i>
<i>ANEKS 2. KONTRATA SOCIALE E DETAJUAR.....</i>	<i>25</i>
REFERENCA.....	26

Shkurtime

NE	Ndihmë Ekonomike
NJA	Njësi Administrative
URB	Zonat Urbane
RUR	Zonat Rurale
GZHK	Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë”
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
KB	Këshilli Bashkiak
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
PAK	Personat me aftësi të kufizuar
POP	Përballja e Ofertave Politike
MKR	Mekanizmi i Koordinuar i Referimit
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
COVID - 19	Pandemia e Virusit Korona
Kontrata Sociale	6 prioritetet kryesore të identifikuara nga qytetarët gjatë 2021
AZHRB	Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural

Falenderime

Për të hartuar botimin e dytë të Raportit të monitorimit të Kontratës Sociale, bashkëpunuam me shumë aktorë e institucione. Falenderojmë Bashkinë Korçë dhe drejtoritë përkatëse, për vënien në dispozicion të informacioneve të kërkuara, Kryetarin e Bashkisë z. Sotiraq Filo, Drejtoreshën e Kabinetit Bashkia Korçë znj. Brunilda Prifti, Koordinatorin për të Drejtën e Informimit znj. Larisa Katundi, Kryetarin e Këshillit Bashkiak z. Erjon Nexhipi për disponibilitetin e tyre në komunikimet e vazhdueshme përgjatë monitorimit të Kontratës Sociale të Korçës.

Falenderojmë në mënyrë të veçantë qytetarët që pranuan t'i përgjigjeshin pyetjeve tona, anëtarët e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP), si edhe një falenderim për stafin dhe vullnetarët e Shoqatës “Gruaja në Zhvillim Korçë”, të cilët që prej momentit të nënshkrimit të Kontratës Sociale kanë qenë në monitorim të vazhdueshëm të punës së Bashkisë Korçë dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Gjithashtu, dëshirojmë të falenderojmë Olof Palme International Center dhe NED – National Endowment for Democracy për ndihmën teknike e financiare, pa të cilët do të ishte e pamundur të hartohesh ky raport dhe të realizoheshin aktivitete të ndryshme nga Rrjeti POP.

Hyrje

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP” synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë vendore, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë), ndërsa tre bashki të reja u bënë pjesë e këtij procesi në vitin 2021, përmes replikimit të procesit edhe në bashkitë e Elbasanit, Vau i Dejës dhe Korçë duke e çuar në 12 numrin e bashkive nën monitorimin e organizatave të shoqërisë civile anëtare të rrjetit POP. Gjatë periudhës shtator 2021-2022 për të tretin vit me radhë, rrjeti POP monitoroi zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Ky është viti i tretë i monitorimit të punës së pushtetit vendor për përfshirjen e prioriteteve të qytetarëve dhe përmbushjen e Kontratës Sociale.

Organizata Gruaja në Zhvillim Korçë u bë pjesë e Rrjetit POP në vitin 2021 duke filluar aktivitetet e saj në muajin maj 2021.

Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë u firmos në datë 27 korrik 2021¹ nga Kryetari i Bashkisë Korçë z. Sotiraq Filo dhe përfaqësuesja e Shoqatës “Gruaja në Zhvillim Korçë”.

Gjatë vitit 2021, projekti i POP vazhdon me “Kontrata Sociale si një mjet për të forcuar marrëdhëniet mes qytetarëve dhe pushtetarëve”, duke vijuar monitorimin dhe bashkëpunimin mes aktorëve kryesorë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve.

Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë² përmban 6 prioritete që qytetarët e Korçës identifikuan gjatë muajve maj-qershor 2021. Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” (GZHK), synoi të krijojë dhe promovojë mekanizma qytetare në funksion të përmirësimit të demokracisë lokale, duke angazhuar qytetarët, partitë politike, kandidatët për deputetë në zgjedhjet parlamentare të 2021, stafin e Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak të dialogojnë dhe të punojnë për realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale. GZHK mundësoi vlerësimin dhe monitorimin e performancës së administratës lokale dhe të zgjedhurve vendorë duke promovuar dialog dhe bashkëpunim në nivel vendor. Në Bashkinë Korçë, Kontrata Sociale bëri që komuniteti të ketë një mjet për të mbajtur stafin e bashkisë dhe Këshillin Bashkiak përgjegjës për adresimin e prioriteteve të tyre, por duke përdorur edhe zgjedhjet parlamentare

¹ Firmosja e Kontratës Sociale për Bashkinë Korçë:

<https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/photos/pcb.1022029351791444/1022027958458250/>

² Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë:

https://popnetwork.al/.../07/Kontrata-Sociale_Korca-A3.pdf

të 2021, advokoi me kandidatët për deputetë të forcave të ndryshme politike, nëpërmjet një Forumi Publik për të futur në agjendat politike edhe prioritetet e Kontratës Sociale.³

Në botimin e parë të monitorimit⁴ të Kontratës Sociale për Bashkinë Korçë, për periudhën shtator-dhjetor 2021, 25 % e prioriteteve të qytetarëve u adresuan.⁵

Botimi i parë i Raportit monitorues është ndarë gjerësisht me përfaqësues të Bashkisë Korçë, anëtarë të Këshillit Bashkiak si edhe me qytetarët, duke analizuar arritjet, por edhe punën që duhet bërë për përmbushjen e atyre prioriteteve që janë adresuar pak dhe kanë nevojë për një vëmendje më të shtuar të pushtetit vendor.

GZHK ka lobuar për të gjitha çështjet e Kontratës Sociale, por mundet të veçojmë 2 prej tyre për të cilat kemi patur mbështetje nga qytetarët, të cilët janë përfshirë në një peticion dhe jo vetëm, por edhe kanë qenë konsistentë në kërkesat e tyre, në takimin konsultues për projekt-buxhetin e vitit 2022⁶, në mbledhje të Këshillit Bashkiak, në takime me përfaqësues nga Këshilli Bashkiak dhe drejtoritë përkatëse duke advokuar për:

Rikonstrukcionin e shkollës në fshatin Bulgarec.

Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore në Lgj.4, Rajoni 1, qyteti Korçë.

*Ky raport vlerëson progresin e bërë në realizimin e prioriteteve të Kontratës Sociale për periudhën **Dhjetor2021 – Shtator 2022**.*

Gjatë këtij monitorimi organizata kishte si qëllim:

- Të monitorojë Këshillin Bashkiak dhe veprimtarinë e Bashkisë për marrjen dhe zbatimin e masave në kuadër të adresimit të prioriteteve të Kontratës Sociale.
- Të raportojë gjetjet dhe rekomandimet.
- Të llobojë dhe advokojë për përmbushjen e prioriteteve të qytetarëve, sidomos në kuadër të dimensionit social, transparencës dhe llogaridhënies.
- Të përdorë gjetjet e Raportit studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”⁷ për angazhimin dhe informimin e qytetarëve.
- Angazhimin e grupeve qytetare në fushata advokimi dhe lobimi për përmbushjen e prioriteteve të Kontratës Sociale.

³ Forumi Publik: <https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/photos/pcb.969194620408251/969194327074947/>

⁴ Botimi i parë i monitorimit të Kontratës Sociale, Bashkia Korçë:

https://popnetwork.al/.../01/Raporti_POP_Bashkia_Korce-3.pdf

⁵ Grafikë mbi adresimin e prioriteteve:

<https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/photos/a.1572047553053488/3184053258519568/>

⁶ Takimi konsultues për projekt-buxhetin e vitit 2022:

<https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/photos/pcb.3092209104370651/3092207221037506>

⁷ Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”, Bashkia Korçë:

<https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-korce/>

Metodologjia

Për të realizuar raportin, GZHK, anëtare e rrjetit POP, u bazua në hapat e mëposhtëm:

- U monitorua puna e Bashkisë Korçë dhe vendimet e Këshillit Bashkiak për periudhën Dhjetor 2021 – Shtator 2022.
- U dërgua një letër-kërkesë me email për informacion Bashkisë Korçë, e cila ktheu përgjigje pasi mori informacionin nga Drejtoritë dhe Departamentet përkatëse, në përputhje të prioriteteve të Kontratës Sociale.
- U organizuan takime me Drejtoreshën e Kabinetit Bashkia Korçë znj. Brunilda Prifti, Kryetarin e Këshillit Bashkiak z. Erion Nexhipi, Administratorë të Njësive Administrative dhe qytetarë të Korçës, mbi ecurinë e punës sa i takon adresimit dhe përmbushjes së prioriteteve të komunitetit të Korçës.
- U realizuan fokus-grupe me anëtarë të komunitetit në 4 Njësi Administrative të Korçës, me pjesëmarrës të cilët kanë qenë pjesë e aktiviteteve të mëparshme dhe kanë kontribuar në përcaktimin e prioriteteve të Kontratës Sociale.
- Në një nga takimet me qytetarët, u bënë pjesë edhe përfaqësues nga Drejtoritë përkatëse që lidhen me çështjet e Kontratës Sociale.
- U bënë vizita në terren për të parë nga afër ndërhyrjet e Bashkisë që lidhen me plotësimin e prioriteteve të Kontratës Sociale, duke pyetur edhe qytetarë të rastesishëm në lidhje me këto ndërhyrje.
- U monitoruan vendimet e Këshillit Bashkiak mbi masat e marra nga vetë Bashkia, në lidhje me komunitetin në përgjithësi dhe me disa target-grupe në veçanti, si dhe veprimtaria e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, gjithashtu edhe vendimet që kanë lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale.
- U analizua dhe monitorua buxheti i Bashkisë për vitin 2022, si dhe shpenzimet respektive.
- U monitoruan mediat audiovizive dhe ato sociale në lidhje me sa më sipër sipas fushave specifike.

Përmbledhje ekzekutive

Në bazë të monitorimit të Bashkisë Korçë, të kryer nga Shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” më poshtë renditen disa nga gjetjet kryesore të dala nga ky monitorim. Gjetje nga informacioni i mbledhur në lidhje me 6 prioritetet e Kontratës Sociale – Botimi i dytë i monitorimit Dhjetor 2021 – Shtator 2022:

- Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore për Bashkinë Korçë, është vlerësuar nga qytetarët pjesëmarrës në fokus grupet për hartimin e Kontratës Sociale më prioritari. Për periudhën janar-gusht 2022 janë shtruar dhe riparuar 3,500 m² trotuare. Janë vendosur pllaka betoni trotuari 1,200 m². Përsa i përket zonave të parashtruara në Kontratën Sociale Bashkia Korçë, ka pasur ndërhyrje tek të gjitha në masë 85.8%.

Është e nevojshme një ndërhyrje për sistemimin e ujrave të zeza në rrugën e Koresë, Ulicës dhe Kasabasë në fshatin Mborje.

- Këshilli Bashkiak ka miratuar në mbledhjen e këshillit të muajit maj 2022 kontributin financiar për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollore dhe sportive me cikël financimi 2022-2023. Shuma në total e miratuar 35,103,191 Lek, për rinkonstruksionin e shkollave “Themistokli Gërmenji”, “Ymer Dishnica” dhe Kopshtit numër 6.
- Po punohet për rikonstruksionin e plotë të Shkollës "Themistokli Gërmenji" në Korçë. Projekti përfshin transformimin rrënjësor të ambienteve, ndërtimin e një palestere të re, kabinetin e ri laboratorik dhe vendosjen e të gjitha paisjeve të nevojshme për zhvillimin e mësimin në standarde bashkëkohore. Vlera e objektit me TVSH 75 565 671.3 Lek.
- Ka përfunduar rikonstruksionin në shkollën "Sotir Beçka" në Bulgarec sipas të gjitha kërkesave të parashtruara në peticionin që GZHK realizoi me përfshirjen e qytetarëve nga Bulgareci: ndarja e ambienteve të klasave të ciklit parashkollor nga ato të ciklit 9-vjeçar; shtimi i numrit të tualeteve.
- Gjithashtu në shkollën e fshatit Bulgarec është rikonstruktuar dhe përshtatur një ambient si klasë zhvillimore dedikuar për fëmijët me aftësi ndryshe, është realizuar një kënd i ri lojërash për fëmijët e kësaj shkolle ku fëmijët mund të argëtohen.
- Me qëllim nxitjen e biznesit për të rinjtë, u miratua në paketën fiskale për vitin 2022 përjashtimi nga pagesat e tarifave për vitin 2022 të gjithë subjekteve të cilët do të zhvillojnë për herë të parë aktivitet dhe do të regjistrohen nga studentë të diplomuar

Në universitete brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2020 dhe 2021. Numri i subjekteve të cilat kanë përfituar është 10.

- Gjatë 2022 janë trajnuar mbi 200 të rinj në fusha të ndryshme të inovacionit si: Social Media Manager, Web Programming, Adobe Illustrator, programim si (Java, Python) dhe mbi 15% e të rinjve janë punësuar pas përfundimit të kurseve.
- Bashkia Korçë për periudhën janar-gusht 2022 ka mbuluar shpenzimet për energji, ujë, telefon, internet dhe karburant në vlerën 953,810 mijë lekë për Qendrën e Kujdesit Paliativ Korçë Mary Potter, e cila kujdeset me përkushtim jo vetëm për përmirësimin e jetës së pacientëve me sëmundje malinje gjatë gjithë ecurisë së sëmundjes, por edhe të familjarëve të tyre.
- Në shkurt 2022 janë rihapur 4 qendra të të moshuarve në Korçë, si rezultat i bashkëpunimit të Bashkisë Korçë me Misionin Emanuel. Në këto qendra ofrohen shërbime për të moshuarit. Kapaciteti akomodues është 165 persona, ku 133 i përkasin gjinisë mashkullore dhe 32 i përkasin gjinisë femërore. Të moshuar Rom/Egjiptian janë 60.
- Bashkia Korçë për të disatin vit organizon projektin “Karta për pensionistët”, ku mundëson transportin urban falas për pensionistët. Gjatë 8 mujorit të parë të vitit 2022 janë shpërndarë 392 karta.
- Përsa i përket kujdesit social për familjet dhe fëmijët, për periudhën e monitorimit rezultojnë të dhënat si në vazhdim: 2,855 persona të mbështetur me pagesë invaliditeti; 2,225 persona kanë përfituar pagesë për paaftësi, të verbër, para dhe tetra plegjikë dhe kujdestarët e tyre; 180 gra kryefamiljare kanë përfituar ndihmë ekonomike për periudhën kohore Janar-Gusht 2022, më i lartë se numri respektiv për 2021 për të njëjtën periudhë që arrinte tek 165; mesatarisht 27 familje çdo muaj. për këtë perjudhë kanë përfituar ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor (këto familje në nevojë që nuk janë fituese nga sistemi); 92 fëmijë rom dhe egjiptian. përfitojnë shërbim nga 3 qendra ditore për fëmijë që administrojnë Bashkia Korçë në bashkëpunim me Misionin Emanuel; nuk ka pasur persona të akomoduar për këtë periudhë monitorimi për strehimin e viktimave të dhunës në familje nga 24 në 72 orë në strehëzën që Bashkia menaxhon; 30 fëmijë kanë marrë shërbim pranë “Qendres Ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuara”, e cila menaxhohet nga Bashkia. Vlera totale e shpenzimeve për periudhën janar – gusht 2022 është në vlerën 14,344 mijë lekë. Këtë të fundit e konsiderojmë të nevojshme siç rekomandohet në KS të
-

Bashkisë Korçë që të paktën njëri nga prindërit e familjeve të tyre të jetë i siguruar ose i punësuar.

Janë përjashtuar nga pagesa e tarifave vendore pastrim, ndriçim për vitin 2022 :

- ✓ të gjitha familjet në fshatrat e njësive administrative, në të cilat nuk kryhen këto shërbime;
- ✓ të gjithë familjet, kryefamiljarët e të cilave përfiton ndihmë ekonomike;
- ✓ të gjithë familjet, kryefamiljari i të cilave përfiton vetëm pension pleqërie / pension social, kur familja përbëhet vetëm nga 1 pensionist.

Strehimi i familjeve në nevojë mbetet një nga sfidat. Numri i këtyre familjeve të strehuara për këtë periudhë monitorimi është i ulët: me VKB Korçë, nr.20 dt 10.02.2022⁸ (janë miratuar 20 familje dhe 9 prej tyre kanë kaluar për financim, të tjerët janë në procedurën e plotësimit të dokumentacionit); për banesat sociale me qira që kaluan nga Enti Kombëtar i Banesave pronë e Bashkisë Korçë, realizojnë të ardhura nga zbatimi i procedurës së privatizimit me kontratë kesh 8 familje, kontratë me këste 18 dhe 2 për kontratën e qiradhënies. Mbetet në vazhdim dhe brenda afateve 4 familje.

Nevojitet rritja e numrit të famijeve në nevojë që përfitojnë strehim, gjetja e mekanizmave të reja për zgjidhjen e kësaj çështjeje që është jetike.

Bashkia Korçë organizon çdo vit “Buxhetimin me Pjesëmarrje”. Për periudhën që ky raport monitorimi mbulon, nuk janë zhvilluar akoma takimet për buxhetimin me pjesëmarrje, por mundet të përmendim takimin konsultativ të mëposhtëm:

U zhvillua një takim me përfaqësues të Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë, me përfaqësues të biznesit të madh, ekspertë kontabël dhe anëtarë të bordeve të zonave të biznesit BID dhe TID, ku u diskutua për Paketën Fiskale të vitit 2023, evidentimin e sfidave për të ardhmen, si dhe propozime për nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin e ardhshëm.

Edhe pse Bashkia realizon Buxhetimin me Pjesëmarrje, ngelet një sfidë për Bashkinë rritja e numrit të qytetarëve që përfshihen në këtë proces konsultues edhe sidomos atyre të gjinisë femërore në zonat rurale. Nevojiten të gjenden mekanizma të reja përfshirëse si pyetësorë, etj.

⁸ VKB Korçë nr. 20 dt 10.02.2022: <https://www.vendime.al/wpcontent/uploads/2022/03/Vendim-nr-201.pdf>

Analiza e gjetjeve për secilin Prioritet sipas Kontratës Sociale

Gjetjet nga monitorimi dhe informacioni i Bashkisë Korçë

Prioriteti 1:

Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për bashkinë Korçë.

Programe të Bashkisë Korçë në lidhje me këtë prioritet dhe realizimi i buxhetit për periudhën e monitorimit:

Programi “Rrjeti Rrugor” përfshin ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimin rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-gusht 2022 ka qenë 3,609 mijë lekë, ose realizuar në masën 5% kundrejt planit vjetor të vitit 2022 në vlerën 69,580 mijë lekë. Realizimi ndaj planit të periudhës ka qenë në masën 5%.⁹

Në kuadër të këtij programi ka vazhduar mirëmbajtja e rrugëve rurale dhe urbane dhe janë shtuar dhe riparuar 3,500 m trotuare në qytet. Janë vendosur pllaka betoni trotuari 1,200 m².

Programi “Ndrëçimi i rrugëve” mbulon sigurimin e ndriçimit të rrugëve dhe objektivat e këtij programi janë: hapësirat publike të jenë të ndriçuara për të garantuar siguri në komunitet, si dhe rritjen e mbulimit të territorit me ndriçim publik.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-gusht 2022 ka qenë 35,919 mijë lekë, ose realizuar në masën 38% kundrejt planit vjetor të vitit 2022 në vlerën 94,565 mijë lekë. Realizimi ndaj planit të periudhës ka qenë në masën 60%.

Në Njësitë Administrative mbulohet me ndriçim 75% e sipërfaqes, kurse në qytet mbulohet mbi 95% e sipërfaqes së territorit.

Për përmirësimin e ndriçimit në ambiente publike, gjatë periudhës janar – gusht 2022 janë lidhur 16 kontrata të reja të energjisë elektrike në qytet dhe në Njësitë Administrative, për të shtuar rritjen e efektivitetit të ndriçimit publik.

⁹ RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2022

https://docs.google.com/document/d/1hDg7maHV5KSR0Q-1oaa1EW_8_8agf71p/edit

Në lidhje me prioritetet e Kontratës Sociale bashkia Korçë

Rajoni 1: Përmirësim i trotuareve tek Rr. "Theodhor Kavaljoti", Lajja 10 (Blloku i Francezëvë), ku jetojnë 29 familje të komunitetit Rom, përmirësimi i ndriçimit dhe pastrimit.

Është bërë riparim i trotuarëve, si edhe përmirësimi i ndriçimit në rrugën "Theodhor Kavaljoti".

Në kuadër të aksionit të pastrimit, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike ka ndërhyrë për pastrimin e zonave problematike me ndotje në qytet dhe Njësitë Administrative dhe vazhdon punën për të mbajtur pastër çdo territor të Bashkisë Korçë.

Rajoni 2: Asfaltimi i rrugëve "Mihal Ciko", "Naum Karanxha", "Koli Çeku" (Laj. 4). Paisja me trotuare i rrugëve "Naum Karanxha", "Koli Çeku" dhe "Aleksandra Ilo" (Laj.4)

Është bërë 80% asfaltimi i rrugëve Mihal Ciko, Naum Karanxha dhe Koli Çeku në lagjen 4 të qytetit, si edhe trotuaret. Kanë ngelur pa përfunduar disa akse për arsyen sepse janë në pronësi private.

Rajoni 3: Asfaltimi i rrugëve "Thanas Rëmaçka" (Laj.6) dhe rrugët dytësore tek rruga e Leshpunueses (Laj.18).

Është bërë asfaltimi i rrugëve "Thanas Rëmaçka" dhe "Mujo Ulqinaku", në lagjen 6 të qytetit të Korçës, si edhe i rrugëve në lagjen 18. Gjithashtu është bërë sistemimi i trotuareve në këto rrugë.

Njësia administrative Qendër Bulqarec: Ndërhyrje për të asfaltuar rrugët që lidhin fshatin me zonat jashtë njësisë administrative. Konkretisht, rruqa Bulqarec-Çifliq është e paasfaltuar, ndërsa rruqa Bulqarec-Shamoll ka vetëm një shtresë të shtruar me çakull. Të pajisen rrugët kryesore të fshatit me trotuare dhe specifikisht në Rrugën e Krishterëve. Pajisja me ndriçim i të gjitha rrugëve të fshatit Bulqarec. Ka mungesë ndriçimi në 20% të rrugëve të fshatit, atje ku ka shtëpi të veçuara. Paisja me ndriçim tek Rruqa Nacionale që përfshin zonën prej Urës së Dunavecit, deri tek "Delta".

Aktualisht është asfaltuar rreth 80% e rrugëve të brendshme të fshatit Bulqarec, si edhe rruga Bulqarec-Çiflig. Është pajisur me trotuar "Rruga e Krishterëve", 90% e rrugëve të fshatit janë të pajisura me ndriçim publik. Gjithashtu, vijon puna për çakullimin e rrugëve të parcelave në fshatin Bulqarec.

Njësia administrative Drenovë

Drenova është pjesë e projektit "100 fshatrat" dhe një nga prioritetet e Bashkisë Korçë, për ta shndërruar atë ashtu si Dardha e Voskopoja, në një destinacion turistik. Pas punës për rehabilitimin e rrugës në një nga zonat më të veçanta në Shqipëri Parkut Kombëtar "Bredhi i

Drenovës", një perlë e natyrës, është punuar brenda fshatit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Fshati Mborje: Asfaltimi i rrugës prej shkollës deri në qendër dhe Rr. "Pavlo Sholla". Sistemimi i ujrave të zeza në rrugën e Koresë, Ulicës dhe Kasabasë. Paisja e rrugëve me ndriçim, sepse ka ndriçim vetëm në rrugët kryesore.

Është bërë asfaltimi i rrugës nga shkolla deri në qendër, si edhe rruga "Pavlo Sholla".

Në lidhje me ndriçimin, nga informacioni i marrë nga qytetarët janë riparuar shtyllat dhe ndriçimi është mirë.

Njësia administrative Mollaj. Fshati Mollaj: Asfaltimi i rrugës së Sallatashit. Përfundimi i rrugëve "Haxhi Sherif" dhe "Xhamia". Shtrimi i rrugëve drejt parcelave bujqësore.

Është bërë asfaltimi i rrugëve "Haxhi Sherif dhe Xhamia". Vijon puna për çakullimin e rrugëve të parcelave.

Prioriteti 2 :

Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

Njësia administrative Korçë (Qyteti Korçë)

• Rikonstruksioni i gjimnazit "Themistokli Gërmenji": ndërrimi i dritareve, të cilat janë shumë të amortizuara dhe ulin efikasitetin e ngrohjes gjatë muajve të dimrit dhe ndërrimi i kaldajës. Rikonstruksion i dritareve dhe tualeteve tek gjimnazit Gjimnazi 3, brenda ambienteve të së cilës ka shumë laqështi duke ndikuar në ngrohje. Ndërtimi i një palestere për këtë shkollë. Ndërrhyrje në ambientet e brendshme të shkollës nëntëvjeçare "Asdreni", si dhe tek këndi sportiv i saj, i cili është jashtë parame trave sportive. Rikonstruksioni i shkollës "Ismail Qemali".

- ✓ Në lidhje me këtë prioritet Këshilli Bashkiak ka miratuar në mbledhjen e Këshillit të muajit maj kontributin financiar për financimin e projekteve për infrastrukturën shkollë dhe sportive me cikël financimi 2022-2023. Shuma e miratuar për bashkëfinancim projektsh në total 35,103,191 Lekë, për rikonstruksionin e shkollave "Themistokli Gërmenji", "Ymer Dishnica" dhe Kopshtit numër 6. (Vendim nr.80, datë 23.05.2022)¹⁰
- ✓ Vazhdon puna për rikonstruksionin e plotë të Shkollës "Themistokli Gërmenji" në Korçë. Projekti përfshin transformimin rrënjësor të ambienteve, ndërtimin e një palestere të re, kabinetin e ri laboratorik dhe vendosjen e të gjitha paisjeve të nevojshme për zhvillimin e mësimin në standarde bashkëkohore.

¹⁰VKB Korçë nr. 80 dt 23.05.2022: <https://www.vendime.al/wpcontent/uploads/2022/06/Vendim-Nr.80.pdf>

Ky rikonstruksion u tenderua në vlerë pa TVSH 72 500 000 Lekë ¹¹. Vlera e objektit me TVSH 75 565 671.3 Lek.

Njësia administrative Qendër Bulgarec

Shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Bulgarec, të cilat përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. (kopësht, arsimi i mesëm i ulët dhe arsimi i mesëm i lartë). Ka pamjaftueshmëri të tualeteve në këtë shkollë. Ndërtimi i një palestere dhe një ambienti për argëtim dhe lojra jashtë orarit shkollor. Për këtë qëllim u propozua nga banorët që të shfrytëzohet një mjedis i lirë pranë shkollës.

Ka përfunduar rikonstruksioni në këtë shkollë sipas të gjitha kërkesave të parashtruara në petitionin që GZHK realizoi me përfshirjen e qytetarëve nga Bulgareci si më poshtë:

- ✓ Ndarja e ambienteve të klasave të ciklit parashkollor nga ato të ciklit 9-vjeçar.
- ✓ Shtimi i numrit të tualeteve.

Gjithashtu:

- ✓ Është rikonstruktuar dhe përshtatur një ambient si klasë zhvillimore dedikuar për fëmijët me aftësi ndryshe.
- ✓ Është realizuar një kënd i ri lojërash për fëmijët e kësaj shkolle ku fëmijët mund të argëtohen.

Njësia administrative Drenovë

Ndërtimi i një këndi sportiv në shkollën e fshatit Mborje në territorin pas shkollës.

Nuk ka patur ndërhyrje përsa i përket ndërtimit të një këndi sportiv në shkollën e fshatit Mborje në territorin pas shkollës.

Njësia administrative Mollaj

Shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Mollaj, të cilat përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. Izolimi i laqështisë tek shkolla e fshatit Mollaj, e cila ka ajër shumë të rënduar për shkak të laqështisë dhe amortizimit.

Edhe në këtë Njësi nuk ka patur ndërhyrje në shkollën e fshatit Mollaj, siç është parashtuar në Kontratën Sociale.

Prioriteti 3:

Nxitja e politikave të punësimit për të rinjtë nëpërmjet incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për ta.

Një nga lehtësitë që u është ofruar të rinjve me qëllim nxitjen e biznesit është përjashtimi nga pagesat e tarifave për vitin 2022 të gjithë subjekteve të cilat do të zhvillojnë për herë të

¹¹ Open Procurement Albania: <https://openprocurement.al/sq/tender/view/id/48372>

parë aktivitet dhe regjistruhen nga studentë të diplomuar në universitete brenda dhe jashtë vendit gjatë vitit 2020 dhe 2021. Numri i subjekteve të cilat kanë përfituar është 10.

Vizioni i Bashkisë Korçë është kthimi i Korçës në kryeqendër të teknologjisë dhe inovacionit. Për këtë arsye është fokusuar në trajnimin dhe punësimin e të rinjve në tregun global për të punuar si freelancer në kompani të ndryshme të botës. Një numër i caktuar i trajnimeve janë financuar nga buxheti i Bashkisë. Gjatë 2022 janë trajnuar mbi 200 të rinj në fusha të ndryshme të inovacionit si: Social Media Manager, Web Programming, Adobe Illustrator, programim si (Java, Python) dhe mbi 15% e të rinjve janë punësuar pas përfundimit të kurseve. Bashkia Korçë është gjithashtu mbështetës për bizneset e para start up.

Prioriteti 4:

Ritja e ndihmës për grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Për tu arritur në ndihmë grupeve në nevojë Bashkia Korçë zbaton programet e mëposhtëme:¹²

Sigurimi Shoqëror

Ky program përfshin administrimin dhe mirëmbajtjen e qendrave rezidenciale për të moshuarit.

Mbështetja, kujdesi dhe rritja e mirëqënies për personat e moshës së tretë, krijimi i kushteve të përshtatshme dhe ofrimi i shërbimeve psiko-sociale, mjekësore, kulturore e argëtuese për të moshuarit është një nga qëllimet e këtij programi. Shërbimi për moshat e treta realizohet sipas standardit kombëtar për këto shërbime.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-gusht 2022 ka qenë 3,440 mijë lekë ose realizuar në masën 47% kundrejt planit vjetor të vitit 2022 në vlerën 7,392 mijë lekë.

Bashkia për periudhën janar-gusht 2022 ka mbuluar shpenzimet për energji, ujë, telefon, internet dhe karburant në vlerën 953,810 mijë lekë. mijë lekë për Qendrën e Kujdesit Paliativ Korçë Mary Potter. Kjo qendër kujdeset me përkushtim jo vetëm për përmirësimin e jetës së pacientëve me sëmundje malinje gjatë gjithë ecurisë së sëmundjes, por edhe të familjarëve të tyre.

Në shkurt 2022 janë rihapur 4 qendra të të moshuarve në Korçë, si rezultat i bashkëpunimit të Bashkisë Korçë me Misionin Emanuel. Në këto qendra ofrohen shërbime për të moshuarit, kapaciteti akomodues është 165 persona. Ku 133 i përkasin gjinisë mashkullore dhe 32 i përkasin gjinisë femërore. Të moshuar Rom/Egjiptian janë 60.

¹² RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2022:

https://docs.google.com/document/d/1hDg7maHV5KSROQ-1oaa1EW_8_8agf71p/edit#

Bashkia Korçë për të disatin vit, organizon projektin “Karta për pensionistët”, ku mundëson transportin urban falas për pensionistët. Gjatë 8 mujorit të parë të vitit 2022 janë shpërndarë 392 karta.

Gjatë vitit 2022 kanë patur ulje dhe përjashtime nga pagesa e tarifave vendore për subjekte të ndryshme dhe përjashtime për familjet në nevojë.

Janë përjashtuar nga pagesa e tarifave vendore pastrim, ndriçim për vitin 2022 :

- të gjitha familjet në fshatrat e njësive administrative, në të cilat nuk kryhen këto shërbime;
- të gjithë familjet, kryefamiljarët e të cilave përfiton ndihmë ekonomike;
- të gjithë familjet, kryefamiljari i të cilave përfiton vetëm pension pleqërie / pension social, kur familja përbëhet vetëm nga 1 pensionist.

Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Ky program ka si qëllim mbështetjen në para dhe në natyrë për familjet dhe fëmijët në vështirësi social ekonomike. Shërbimi i kujdesit social për familjet dhe fëmijët realizohet sipas standardit kombëtar.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-gusht 2022 ka qenë 18,896 mijë lekë, kundrejt planit vjetor të vitit 2022 në vlerën 41,818 mijë lekë.

Persona të mbështetur me pagesë invaliditeti janë 2,855. Persona që përfitojnë pagesë për paaftësi, të verbër, para dhe tetra plegjikë dhe kujdestarët e tyre janë 2,225.

Bashkia Korçë administron 3 qendra ditore për fëmijë në bashkëpunim me Misionin Emanuel. Këto qendra për periudhën kohore Janar-Gusht 2022 i kanë frekuentuar 92 fëmijë rom dhe egjiptian.

Numri i grave kryefamiljare që kanë përfituar ndihmë ekonomike është 180 për periudhën kohore Janar-Gusht 2022, në krahasim me 165 që kanë qenë për të njëjtën periudhë të 2021.

Dhënia e ndihmës ekonomike nga fondi i buxhetit vendor për familjet në nevojë që nuk janë fituese nga sistemi. Numri i familjeve përfituese ka ndryshime të vogla nga muaji në muaj. Ai ka qenë mesatarisht 27 familje çdo muaj.

Bashkia Korçë menaxhon një strehëzë emergjence, për strehimin e viktimave të dhunës në familje nga 24 në 72 orë. Gjatë periudhës janar-gusht nuk ka pasur person të akomoduar.

Në Bashki funksionon “Qendra Ditore e fëmijëve me aftësi të kufizuara”, në të cilën marrin shërbim 30 fëmijë.

Bashkia administron, organizon dhe mbështet skemat e mbrojtjes shoqërore për personat e sëmurë dhe PAK. Ky shërbimi realizohet sipas standardit kombëtar.

Realizimi i shpenzimeve për këtë program për periudhën janar-gusht 2022 ka qenë 9,021 mijë lekë, ose realizuar në masën 63% kundrejt planit vjetor të vitit 2022 në vlerën 14,344 mijë lekë.

Strehimi mbetet një nga sfidat me objekt evidentimin dhe zgjidhjen e problematikave për familjet në nevojë për strehim.

Me VKB 20 dt 10.02.2022 (janë miratuar 20 familje dhe 9 prej tyre kanë kaluar për financim të tjerët janë në procedurë e plotësimit të dokumentacionit).¹³

Për banesat sociale me qira që kaluan nga Enti Kombëtar i Banesave pronë e Bashkisë Korçë realizojnë të ardhura nga zbatimi i procedurës së privatizimit me kontratë kesh 8 familje, kontratë me këste 18 dhe 2 për kontraten e qiradhënies. Mbetet në vazhdim dhe brenda afateve 4 familje.

Prioriteti 5:

Trajtim me prioritet i programeve që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës, strehimin dhe integrimin në punë dhe shoqëri të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Strehimi: Zona e ish-Gjeologjikes, konvikti i shkollës bujqësore, konvikti tek shkolla "Demokracia". Për momentin kërkohet nga qytetarët dezinfektimi i ambienteve, t'u sigurohet ujë i pijshëm dhe restaurim i konvikteve ku ata banojnë në këto zona.

Për familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian të strehuara në zonat e ish Gjeologjikes, konvikti i shkollës bujqësore, apo ish konvikti i ndërtimit, Bashkia sugjeron zgjidhje nëpërmjet instrumentit financiar të subvencionimit të qirasë sociale, individët/familjet e strehuara në këto objekte të sigurojnë një kontratë të qiradhënies dhe më pas të mbështetet me pagesën e qirasë për strehim në kushtet e një apartamenti në përputhje me të gjitha parimet e strehimit social.

Nga takimet e organizuara nga GZHK, në të cilat kanë marrë pjesë anëtarë të këtij komuniteti, rezulton se qytetarët e këtyre zonave jo vetëm që nuk plotësojnë kriteret për të përfituar nga banesat sociale për faktin sepse nuk kanë mundësi për shlyerjen e kredisë, por për ta është shumë e vështirë të sigurojnë edhe një kontratë qiradhënie për shkak të paragjyqimeve kundrejt tyre.

Në shkurt 2022 janë rihapur 4 qendra të të moshuarve në Korçë, si rezultat i bashkëpunimit të Bashkisë Korçë me Misionin Emanuel. Në këto qendra ofrohen shërbime për të moshuarit, kapaciteti akomodues i të cilëve është 165, ku prej tyre Rom/Egjiptian janë 60.

Arsimi: Kërkohet që t'u jepet mundësi fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian të regjistrohen dhe të frekuentojnë kopshtet me drekë pa pagesë, pavarësisht statusit të papunë të prindit.

¹³VKB Korçë, nr. 20 datë 10.02.2022 : <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2022/03/Vendim-nr-201.pdf>

Bashkia Korçë administron 3 qendra ditore për fëmijë në bashkëpunim me Misionin Emanuel. Këto qendra për periudhën kohore janar-gusht 2022 i kanë frekuentuar 92 fëmijë rom dhe egjiptian.

Gjithashtu Bashkia ka organizuar aktivitete të ndryshme për këtë komunitet. Nxënësit e shkollave të mesme nga komuniteti Rom&Egjiptian përfitojnë librat falas, bursa të vogla si ndihmë ekonomike.

Prioriteti 6 :

Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për Buxhetimin me Pjesëmarrje, për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin, të marrë këndvështrimin e qytetarëve mbi vendimmarrjet më të rëndësishme.

Bashkia Korçë në kuadër të programit “Bashkia për qytetarët” organizon çdo vit “Buxhetimin me pjesëmarrje”. Buxhetimi me pjesëmarrje është një mekanizëm që lejon qytetarët të marrin pjesë në vendimmarrje dhe ngritjen e transparencës në procesin e hartimit të buxhetit. Në takimet e hapura që zhvillohen me banorët e qytetit dhe njësive administrative qytetarëve u krijohet mundësia për të diskutuar mbi projektbuxhetin dhe Paketën Fiskale. Kjo praktikë financiare ka për qëllim të rritë pjesëmarrjen e zërit të qytetarëve, si dhe ndihmon qeverisjen vendore për të përmirësuar përgjegjësinë mbi buxhetin. Buxhetimi me Pjesëmarrje i ofron mundësinë qytetarëve për të vendosur së bashku me pushtetin vendor për prioritetet më të rëndësishme në zonën ku ata banojnë.

Për periudhën që ky raport monitoron nuk janë zhvilluar akoma takimet për Buxhetimin me Pjesëmarrje me qytetarët e njësive të ndryshme administrative, por mundet të përmendim takimin konsultativ të mëposhtëm:

U zhvillua në bashki një takim me përfaqësues të Shoqatës së Biznesit të Vogël dhe të Mesëm të Shqipërisë, me përfaqësues të biznesit të madh, ekspertë kontabël dhe anëtarë të bordeve të zonave të biznesit BID dhe TID. Gjatë këtij takimi u diskutua për Paketën Fiskale të vitit 2023, evidentimin e sfidave për të ardhmen, si dhe propozime për nivelin e taksave dhe tarifave vendore për vitin e ardhshëm.

Vlerësim i thelluar dhe Përfundime

Ajo çfarë mund të prezantojmë në këtë fazë të projektit është se Bashkia ka treguar seriozitet dhe angazhim në përmbushjen e prioriteteve, dhe ky fakt reflektohet në përmbushjen e 58.16% të prioriteteve të hartuara në Kontratën Sociale të firmosur në korrik 2021.

Qasja e qytetarëve të Korçës për t'u bërë pjesë e monitorimit dhe diskutimet në fokus-grupet e realizuara pësoi një rritje. Shoqata "Gruaja në Zhvillim Korçë" do të vijojë përsëri monitorimin e punës së Bashkisë, drejtorive përkatëse, si edhe vendimeve të Këshillit Bashkiak pranë kësaj Bashkie. Në vijim të punës sonë është e nevojshme që të merren parasysh edhe prioritetet e reja të cilat do të dalin nga takimet e Buxhetimit me Pjesëmarrje që Bashkia do të organizojë dhe stafi I GZHK do të monitorojë.

Disa prej prej prioriteteve të reja të evidentuara nga fokus grupet e realizuara gjatë vitit 2022 po i listojmë në vazhdim:

Infrastruktura rrugore

Qytetarët kërkuar marrjen në konsideratë për adresim për zgjidhje të problematikave të mëposhtme:

NJA Qyteti Korçë

Rajoni 2:

Lagjia 4: Rrugët "Pandi Raidhi", "Kajo Babieni" dhe "Marko Boçari" kanë nevojë për kanalizime dhe asfaltim.

Lagjia15: Pastrimi dhe mirëmbajtja e lulishtes në rrugën "Nexhip Vinçani", lgj.15, Korçë e cila është në gjendje jo të mirë.

Rajoni 3:

Lagjia 6: Tek rruga e "Fajancës" (pallatet mbrapa), mungojnë këndet e lojrave për fëmijë.

Lagjia.7: Tek rruga "Asim Vokshi" kërkohet nga banorët të vendosen policët e shtrirë, pasi rrezikohet jeta e fëmijëve të asaj zone.

Blloku "8 Nëntori": një pallat qëndron mbi ujrat e zeza, për shkak të çarjes së tubacioneve të shkarkimit të këtyre ujrave, duke u bërë shqetësim i vazhdueshëm i banorëve të kësaj zone. Banorët kanë dërguar petition pranë bashkisë, por nuk kanë arritur ta zgjidhin këtë problem.

Sheshi i "Bashkisë se vjetër": kërkohet ndërhyrje_pasi është i pandërtuar. (në lidhje me këtë ka problematikë pasi është pjesërisht pjesë e shtetit dhe pjesërisht pronë private).

Rruga"28 Nëntori": (pranë klinikës Intermedika) është një rrugë e shkurtër dhe e vetmja e paasfaltuar në këtë zonë.

Rruga tek "Xhamia e Vjetër": Kërkohet nga qytetarët asfaltimi i kësaj rruge sepse është e paasfaltuar.

Rajoni 3, Laqija 8

Laqija tek "ura e Fajancës" (prapa ish Artistikes), ka mungesë kanalizimesh dhe ndriçimi. Qytetarët këkuan që të merret në konsideratë për zgjidhje ky problem.

NJA Bulqarec

NJA Bulqarac, Fshati Bulqarec: Qytetarët kërkuan që rruga hyrëse e fshatit duhet patjetër të pajiset me trotuare sepse është një rrugë tek e cila kalojnë nxënësit e shkollës dhe bëhet burim aksidentesh.



Nxitja e politikave të punësimit për të rinjtë





Të rinjtë kërkojnë:

- ✓ Ofrimin e kurseve me paketa të avancuara që të përshtaten me tregun për digjital-marketing, pa pagesë. Tipe të tilla kursesh ofrohen por janë me pagesë dhe jo të gjithë të cilët janë të interesuar kanë mundësi ti frekuentojnë ato.
- ✓ Mundësi intershipeshesh për të rinjtë të cilët e kanë të vështirë të integrohen në tregun e punës, sepse kërkohet për ta eksperiencë pune të cilën nuk mundet ta kenë sapo përfundojnë studimet.


Aneke

Aneks 1. Paraqitja grafike e rezultateve






Prioriteti 6: Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për Buxhetimin me Pjesëmarrje, për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin, të marrë këndvështrimin e qytaterëve mbi vendimmarrjet më të rëndësishme.



KONTRATA SOCIALE: Rezultatet Shtator 2022



Aneks 2. Kontrata Sociale e detajuar

KONTRATA SOCIALE



PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA KORÇË 27 KORRIK 2021



Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare

Prioritet 1:

Ndërhyrje me investime që përmirësojnë infrastrukturën dhe rrugët dytësore, për bashkinë Korçë në njësitë e mëposhtme:

Njësia administrative Korçë (Qyteti Korçë)

Vendosja e sinjalistikave, tek Trekëndëshi dhe Dritat e Verdha, pasi shpesh kanë ndodhur aksidente. Lagjja 15 ka nevojë për semafor, pasi po bëhet burim aksidentesh.

Rajoni 1: Përmirësim i trotuareve tek Rr. "Theodor Kavaljoti", Lagjja 10 (Biloku i Francezëvë), ku jetojnë 29 familje të komunitetit Rom, përmirësimi i ndriçimit dhe pastrimit.

Rajoni 2: Asfaltimi i rrugëve "Mihal Ciko", "Naum Karanxha", "Koli Çeku" (Lgj. 4). Paisja me trotuare i rrugëve "Naum Karanxha", "Koli Çeku" dhe "Aleksandra Ilo" (Lgj.4).

Rajoni 3: Asfaltimi i rrugëve "Thanas Rëmaçka" (Lgj.6) dhe rrugët dytësore tek rruga e Leshpunueses (Lagj.18).

Njësia administrative Qendër Bulgarec

Ndërhyrje për të asfaltuar rrugët që lidhin fshatin me zonat jashtë njësisë administrative.

Konkretisht, rruga Bulgarec-Çiflig është e paasfaltuar, ndërsa rruga Bulgarec-Shamoll ka vetëm një shtresë të shtruar me çakull. Të pajisen rrugët kryesore të fshatit me trotuare dhe specifikisht në Rrugën e Krishterëve. Pajisja me ndriçim i të gjitha rrugëve të fshatit Bulgarec. Ka mungesë ndriçimi në 20% të rrugëve të fshatit, atje ku ka shtëpi të veçuara. Paisja me ndriçim tek Rruga Nacionale që përfshin zonën prej Urës së Dunavecit, deri tek "Delta".

Njësia administrative Drenovë

Fshati Mborje: Asfaltimi i rrugës prej shkollës deri në qendër dhe Rr. "Pavlo Sholla". Sistemimi i ujrave të zeza në rrugën e Koresë, Ulicës dhe Kasabasë. Paisja e rrugëve me ndriçim, sepse ka ndriçim vetëm në rrugët kryesore.

Njësia administrative Mollaj

Fshati Mollaj: Asfaltimi i rrugës së Sallatashit. Përfundimi i rrugëve "Haxhi Sherif" dhe "Xhamia". Shtrimi i rrugëve drejt parcelave bujqësore.

Prioritet 2: ● Rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.

Njësia administrative Korçë (Qyteti Korçë)

- Rikonstruksioni i gjimnazit "Themistokli Gërmenji": ndërrimi i dritareve, të cilat janë shumë të amortizuara dhe ulin efikasitetin e ngrohjes gjatë muajve të dimrit dhe ndërrimi i kaldajës. Rikonstruksioni i dritareve dhe tualeteve tek gjimnazit "Isuf Gjata" (Gjimnazi 3), brenda ambienteve të së cilës ka shumë lagështi duke ndikuar në ngrohje. Ndërtimi i një palestere për këtë shkollë.
- Ndërhyrje në ambientet e brendshme të shkollës nëntëvjeçare "Asdreni", si dhe tek këndi sportiv i saj, i cili është jashtë parametrave sportivë. Rikonstruksioni i shkollës "Ismail Qemali".

Njësia administrative Qendër Bulgarec

Shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Bulgarec, të cilat përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. (kopësht, arsimit i mesëm i ulët dhe arsimit i mesëm i lartë). Ka pamjaftueshmëri të tualeteve në këtë shkollë. Ndërtimi i një palestere dhe një ambienti për argëtim dhe lojra jashtë orarit shkollor. Për këtë qëllim u propozua nga banorët që të shfrytëzohet një mjedis i lirë pranë shkollës.

Njësia administrative Drenovë

Ndërtimi i një këndi sportiv në shkollën e fshatit Mborje në territorin pas shkollës.

Njësia administrative Mollaj Shtimi i numrit të tualeteve në shkollën e fshatit Mollaj, të cilat përdoren nga tre grupmosha të ndryshme. Izolimi i lagështisë tek shkolla e fshatit Mollaj, e cila ka ajër shumë të rënduar për shkak të lagështisë dhe amortizimit.

Prioritet 3: ● Nxitja e politikave të punësimit për të rinjtë nëpërmjet incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës për ta.

Prioritet 4: ● Ritja e ndihmës për grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Mborje: Kërkohet të jepet ndihmë për strehim për familjet në nevojë dhe sidomos atyre me fëmijë me nevojë të veçanta.
Korçë: Të ketë më shumë shërbime për gratë me fëmijë me aftësi të kufizuara. Për këto familje të paktën njëri nga prindërit të jetë i siguruar ose i punësuar; Përmirësimi i kushteve tek Qendra e të moshuarve.

Prioritet 5: ● Trajtim me prioritet i programeve që nxisin përmirësimin e kushteve të jetesës, strehimin dhe integrimin në punë dhe shoqëri të komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Strehimi: Zona e ish-Gjeologjikes, konvikti i shkollës bujqësore, konvikti tek shkolla "Demokracia". Për momentin kërkohet nga qytetarët dezinfektimi i ambienteve, t'u sigurohet ujë i pijshëm dhe restaurim i konvikteve ku ata banojnë në këto zona.

Arsimi: Kërkohet që t'u jepet mundësi fëmijëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian të regjistrohen dhe të frekuentojnë kopshtet me drekë pa pagesë, pavarësisht statusit të papunë të prindit.

Prioritet 6: ● Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv për Buxhetimin me Pjesëmarrje, për të identifikuar sa më shumë problematika që lidhen me komunitetin, të marrë këndvështrimin e qytatërëve mbi vendimmarrjet më të rëndësishme.

- Të përdorë edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin;
- Të mundësojë përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese;
- Të raportojë sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të tij janë reflektuar në vendimmarrjet e saj.

Shoqata
"Gruaja në Zhvillim Korçë"

Entela MAÇKA



Kryetari i Bashkisë
Korçë

Sotiraj FILO



Referenca

- ❖ Faqja zyrtare e Bashkisë Korçë: <https://www.bashkiakorce.gov.al/site/>
- ❖ Faqja zyrtare e Këshillit Bashkiak Korçë: <https://www.facebook.com/KeshilliBashkiakKorce/>
- ❖ Faqja zyrtare e Kryetarit të Bashkisë: <https://www.facebook.com/filosotiraq/>
- ❖ Faqja zyrtare e Rrjetit POP: <https://popnetwork.al/>
- ❖ Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë: <https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/photos/pcb.1022029351791444/1022027958458250/>
- ❖ Kontrata Sociale për Bashkinë Korçë: https://popnetwork.al/.../07/Kontrata-Sociale_Korca-A3.pdf
- ❖ Forumi Publik: <https://www.facebook.com/POPNetworkAlbania/photos/pcb.969194620408251/969194327074947/>
- ❖ Botimi i parë i monitorimit të Kontratës Sociale, Bashkia Korçë: https://popnetwork.al/.../01/Raporti_POP_Bashkia_Korce-3.pdf
- ❖ Grafikë mbi adresimin e prioriteteve: <https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/photos/a.1572047553053488/3184053258519568/>
- ❖ Takimi konsultues për projekt-buxhetin e vitit 2022: <https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce/photos/pcb.3092209104370651/3092207221037506>
- ❖ Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor”, Bashkia Korçë: <https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-korce/>
- ❖ VKB Korçë nr. 20 dt 10.02.2022: <https://www.vendime.al/wpcontent/uploads/2022/03/Vendim-nr-201.pdf>
- ❖ RAPORTI I MONITORIMIT BASHKIA KORÇË, JANAR-GUSHT 2022 https://docs.google.com/document/d/1hDg7maHV5KSR0Q-1oaa1EW_8_8agf71p/edit

- ❖ VKB Korçë nr. 80 dt 23.05.2022:
<https://www.vendime.al/wpcontent/uploads/2022/06/Vendim-Nr.80.pdf>
- ❖ Open Procurement Albania: <https://openprocurement.al/sq/tender/view/id/48372>
https://docs.google.com/document/d/1hDg7maHV5KSR0Q1oaa1EW_8_8agf71p/edit#
- ❖ VKB Korçë nr. 201 dt Mars 2022:
<https://www.vendime.al/wpcontent/uploads/2022/03/Vendim-nr-201.pdf>
- ❖ Marrveshje bashkwpunimi midis Bashkia Korccw dhe Fondacionit “Misioni Emanuel”:
<https://bashkiakorccw.gov.al/files4users/files/Marr%C3%ABveshje%20Bashk%C3%ABpunimi%20me%20Misionin%20Emanuel.pdf>